



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 55, datë 31.07.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMIN E IMPIANTIT GJENERUES TË ENERGISË ELEKTRIKE  
FOTOVOLTAIKE, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW DHE VEPRAT  
NDIHMËSE”, ME VENDNDODHJE NË SHEQ MARINËZ, BASHKIA FIER

Në mbështetje të neneve, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “SLR Albania” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe veprat ndihmëse”, me vendndodhje në Sheq Marinëz, Bashkia Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “SLR Albania” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



ANËTAR/SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/12/2024